



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-05

Prokurori kundër Salih Mustafës

Vendosi: Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 20 janar 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i Redaktuar Publik i

Vendimit mbi Mocionin për Zgjatjen e Afatit të Dorëzimit të Parashtrimeve në lidhje me Aktekspertizat

T'i njoftohet:

Prokurorit të Specializuar:

Xhek Smith

Mbrojtësit të të akuzuarit:

Julius von Bone

Mbrojtëses së viktimave:

Ani Pues

TRUPI GJYKUES I (“Trupi Gjykues”) nxjerr këtë vendim të dytë mbi mocionin për zgjatjen e afatit për parashtrimet mbi aktekspertizat e ekspertëve.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 3 shtator 2021, Trupi Gjykues shpalli “Vendimin e Tretë mbi Caktimin e Ekspertëve” (Vendimi i Tretë mbi Caktimin e Ekspertëve), ku caktoi tre individë si ekspertë në këtë çështje aktuale (Ekspertët e Caktuar), duke i udhëzuar të raportnin në lidhje me temat e identifikuara nga Trupi Gjykues deri më 22 nëntor 2021, dhe duke udhëzuar Mbrojtjen e Salih Mustafës (Mbrojtja) dhe mbrojtësen e viktimave që të dorëzonin parashtrime mbi aktekspertizën, nëse dëshironin, brenda dy javësh nga njoftimi.¹

2. Më 19 nëntor 2021, me kërkesë të Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave² dhe mbrojtëses së viktimave,³ Trupi Gjykues e zgjati afatin për parashtrimin e aktekspertizës (aktekspertizave) deri më 17 dhjetor 2021 dhe afatin për parashtrime mbi aktekspertizën (aktekspertizat) nga mbrojtja dhe mbrojtësja e viktimave deri më 21 janar 2022.⁴

¹ KSC-BC-2020-05, F00184/RED, Trupi Gjykues I, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit të Tretë mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)* 3 shtator 2021.

² KSC-BC-2020-05, F00252, Zyra Administrative, *Kërkesë për Zgjatje të Afatit për Dorëzimin e Aktekspertizës (Aktekspertizave)*, 15 nëntor 2021, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u protokollua më 17 nëntor 2021, F00252/RED

³ KSC-BC-2020-05, F00259, Mbrojtësja e Viktimave, *Përgjigja e Mbrojtëses së Viktimave ndaj Kërkesës për Zgjatjen e Afatit për Dorëzimin e Aktekspertizës (Aktekspertizave)*, të datës 15 nëntor 2021 (F00252), 18 nëntor 2021, publik.

⁴ KSC-BC-2020-05, F00260, Trupi Gjykues I, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesat për Zgjatjen e Afatit për Dorëzimin e Aktekspertizës (Aktekspertizave) dhe Parashtrime në lidhje me To*, 19 nëntor 2021, publik.

3. Më 17 dhjetor 2021, Zyra Administrative dërgoi⁵ aktekspertizat përkatëse të ekspertëve të caktuar (aktekspertizat).⁶
4. Më 14 janar 2022, Administratorja dërgoi përkthimin në anglishte të njëjës nga aktekspertizat.⁷
5. Më 20 janar 2022, mbrojtësja e viktimave parashtrori kërkesë për zgjatjen e afatit për parashtrime mbi aktekspertizat deri më 25 janar 2022 (Kërkesa).⁸

II. PARASHTRIME

6. Mbrojtësja e viktimave parashtron se fakti që përkthimi në anglishte i njëjës nga aktekspertizat iu dorëzua asaj vetëm më 14 janar 2022 dhe jashtë orarit zyrtar, përbën arsye të vlefshme për zgjatjen e afatit deri më 25 janar 2022 për dorëzimin e parashtrimeve të saj mbi aktekspertizat.⁹ Mbrojtësja e viktimave afirmon më tej se, jo vetëm që asaj i mbetën vetëm pesë ditë pune midis dorëzimit të përkthimit të lartpërmendur dhe afatit për parashtrimet, por edhe se seancat gjyqësore ku ajo mori pjesë zgjatën dy ditë brenda këtyre pesë ditëve, duke mos i lënë kohë të mjaftueshme për përgatitjen e parashtrimeve, të cilat kërkojnë analizë të konkluzioneve kryesore të aktekspertizave, përfshirë analizën krahasuese të tyre.¹⁰

⁵ KSC-BC-2020-05, F00287, Administratorja, *Dërgimi i Aktekspertizave*, 17 dhjetor 2021, publik, me shtojcat 1, 3, 5-6, konfidencial, dhe shtojcat 2-4, publike

⁶ KSC-BC-2020-05, F00287/A01, Administratorja, *Aktekspertizë e Parashtruar nga [REDAKTUAR]*, 17 dhjetor 2021, konfidencial (Versioni i redaktuar publik u protokollua më të njëjtën ditë, F00287/A02); F00287/A03, Administratorja, *Aktekspertizë e parashtruar nga [REDAKTUAR]*, 17 Dhjetor 2021, konfidencial (Versioni i redaktuar publik u protokollua më të njëjtën ditë, F00287/A04); F00287/A06, Administratorja, *Aktekspertizë e parashtruar nga [REDAKTUAR]*, 17 Dhjetor 2021, konfidencial.

⁷ KSC-BC-2020-05, F00287/A06/eng, Administratorja, *Aktekspertizë e parashtruar nga [REDAKTUAR]*, 14 Janar 2022, konfidencial Versioni i redaktuar publik u protokollua më të njëjtën ditë, F00287/A06/eng/RED.

⁸ KSC-BC-2020-05, F00291, Mbrojtësja e Viktimave, *Mocion për Zgjatjen e Afatit të Dorëzimit të Parashtrimeve në lidhje me Aktekspertizat*, 20 janar 2022, publik.

⁹ Kërkesë, para. 6 dhe poshtëshënimi 6.

¹⁰ Kërkesë, para. 7 dhe poshtëshënimi 7.

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

7. Trupi Gjykses mban parasys h nenin 40(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullën 9(5) dhe (6) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja).

IV. ANALIZË

8. Trupi Gjykses vëren qysh në fillim se Kërkesa u dorëzua vetëm një ditë para përfundimit të afatit përkatës. Lidhur me këtë, Trupi Gjykses vëren se, në të ardhmen, palët dhe mbrojtësja e viktimave duhet të përpiqen që të dorëzojnë kërkesat sipas rregullës 9(5) të Rregullores në kohë të mjaftueshme përpara mbarimit të afatit në fjalë.

9. Duke mbajtur parasys h arsyet e paraqitura nga mbrojtësja e viktimave, sidomos faktin që përkthimi i njërës nga aktekspertizat iu dha asaj vetëm një javë përpara afatit për parashtrime, jashtë orarit zyrtar, si dhe faktin që përgatitja e parashtrimeve për aktekspertizat kërkon, ndër të tjera, kryerjen e një analize krahasuese të tyre, Trupi Gjykses mendon se është provuar ekzistenca e arsyeve të vlefshme që përlligjin zgjatjen e afatit të kërkuar. Gjithashtu, duke theksuar se edhe për Mbrojtjen vlej në mënyrë të barabartë të njëjtat arsye për zgjatjen e kërkuar të afatit nga mbrojtësja e viktimave, në rast se Mbrojtja dëshiron të paraqesë parashtrime, Trupi Gjykses zgjat deri më 25 janar 2022 edhe afatin për parashtrimet e Mbrojtjes mbi aktekspertizat.

10. Duke pasur parasys h se zgjatja e kërkuar nuk shkakton vonesë në procesin gjyqësor, dhe duke theksuar se Mbrojtjes i është miratuar e njëjta zgjatje afati për dorëzimin e parashtrimeve mbi aktekspertizat, në se ajo dëshiron, Mbrojtja nuk

paragjykohet nga lëshimi i këtij vendimi përpara përgjigjes së saj ndaj Kërkesës, në përputhje me rregullën 9(6) të Rregullores.

V. VENDIM

11. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a. **MIRATON** Kërkesën; dhe
- b. **UDHËZON** Mbrojtjen dhe mbrojtësen e viktimave të dorëzojnë parashtrimet mbi aktekspertizat brenda të martës, 25 janar 2022, nëse dëshirojnë.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia

Kryegjykatëse

/nënshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nënshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E enjte, 20 janar 2022

Hagë, Holandë.